



Prishtinë, 13 qershor 2018
Kodi i ZRRE-së: V_985_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 19, 20 dhe 21 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja;
- Vendimit mbi Njoftimin për Autorizim Preliminar V_604_2013 të datës 27 dhjetor 2013;
- Vendimin V_765_2016 për shtyrje të vlefshmërisë së vendimit për autorizimin preliminar V_604_2013 të datës 27 dhjetor 2013;
- Vendimin mbi Pranimin në Skemën Mbështetëse V_684_2015 të datës 20 shkurt 2015;
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V_824_2016 të datës 23 qershor 2016 lëshuar shoqërisë "Air - Energy" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, në Lokacionin "Wind Park –KITKA" me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW, ZK Hogoshtë, Poliçk dhe Velegllavë e Epërme, komuna e Kamenicës; dhe
- Kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final V_824_2016 të datës 23 qershor 2016 për Modifikimin e Turbinave të Erës nga 10 turbina sa ishin të Autorizuara në 9 Turbina, dhe kapaciteti i instaluar mbetet i pa ndryshuar 32.4 MW ZK Hogoshtë, Poliçk dhe Velegllavë e Epërme, Komuna e Kamenicës, të datës 21.12.2017 të shoqërisë "Air -Energy" Sh.p.k., me adresë rruga "Isa Boletini"p.n. Gjilan, Republika e Kosovës;
- Kontrata për furnizim me turbina, mendimi profesional nga kompania FOKUS dhe vlerësimi nga General Electric (GE) për llojin e turbinave të propozuara,

në seancën e mbajtur me datë 13 qershor 2018 nxori këtë:

V E N D I M PËR MODIFIKIM TË AUTORIZIMIT FINAL

- I. **APROVOHET** – kërkesa e shoqërisë "Air – Energy" SH.P.K. dhe **MODIFIKOHET VENDIMI PËR AUTORIZIMIT FINAL V_824_2016** i datës 23 qershor 2016, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Turbinat e Erës Wind Park –KITKA, me të cilën modifikohet/reduktohet numri i turbinave nga 10 (dhjet) turbina të erën në 9 (Nëntë) Turbina dhe kapaciteti i instaluar mbetet i pa ndryshuar prej 32.4 MW, ZK Hogoshtë, Poliçk dhe Velegllavë e Epërme, Komuna e Kamenicës, sipas Lejes ndërtimore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor(MMPPH).



- II. **Obligohet** shoqëria “Air – Energy” Sh.p.k, pas përfundimit të punëve ndërtimore sipas dispozitivit nën pikën I. të këtij vendimi, të aplikon për Certifikatë të Përdorimit të lëshuar nga Organi kompetent sipas Ligjit të Ndërtimit.
- III. Pas finalizimit të projektit sipas dispozitivit nën pikën II. të këtij vendimi, gjeneratori Wind Park - KITKA, do të hyn në Operim komercial sipas Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Operatorin e Tregut (KOSTT) në kohëzgjatje 12 (dymbëdhjetë) vjeçare, me tarifën nxitëse të përcaktuar me vendimin nr. V_810_2016, të datës 19 maj 2016, të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së, brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent.
- IV. Shoqëria “Air Energy” Sh.p.k, obligohet që të pajiset me Leje Mjedisore (Ekologjike) të lëshuar nga MMPH.

Ar sy e t i m

- ZRRE me datë 25.09.2013 nga ndërmarrja ““Air - Energy” sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Era, me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW, në lokacionin “Wind Park - KITKA”, komuna e Kamenicës, Republika e Kosovës.
- ZRRE pas konstatimit se apikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga ERA, me datë 27 dhjetor 2013 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_604_2013, dhe ka udhëzuar aplikuesin që ti plotësojë kërkesat tjera ligjore që kërkohej me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- ZRRE me datë 07.12.2015 ka pranuar nga shoqëria “Air - Energy” SH.P.K., kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së vendimit mbi njoftimin për Autorizimin Preliminar V_604_2013 të datës 27 dhjetor 2013, edhe për një afat shtesë ligjor, për të kompletuar aplikacionin për marrjen e Autorizimit Final.
- ZRRE me datë 28 janar 2015 ka lëshuar vendimin nr. V_765-2016 për shtyrjen e vlefshmërisë së afatit të vendimit mbi njoftimin për Autorizimin Preliminar V_604_2013 të datës 27 dhjetor 2013, edhe për 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me **27 qershor 2016**.
- ZRRE me datë 06.06.2016 nga shoqëria “Air - Energy” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga ERA, në lokacionin “Wind Park - KITKA”, me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW komuna e Kamenicës, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Lejen Ndërtimore të lëshuar nga MMPH dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- ZRRE me datë 23 qershor 2016 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V_824_2016 shoqërisë “Air - Energy” Sh.p.k, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Turbinat e Erës në Lokacionin “Wind Park –KITKA” me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW, ZK Hogoshtë, Poliqk dhe Velegllavë e Epërme, komuna e Kamenicës.
- ZRRE me datë 21 dhjetor 2017 nga shoqëria “Air - Energy” Sh.p.k, ka pranuar kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final për Modifikimin e Turbinave të Erës nga 10 turbina sa ishin të



Autorizuara në 9 Turbina, dhe kapaciteti i instaluar mbetet i pa ndryshuar 32.4 MW ZK Hogoshtë, Poliçk dhe Velegllavë e Epërme, Komuna e Kamenicës.

- ZRRE s' bashku me kërkesës për Modifikim të Autorizimit Final ka pranuar dëshmitë dhe atë: Mendimin profesional nga kompania Fokus Energy and Engineering Co., Kontrata me furnizim të turbinave, krahasimin e fuqisë instaluese me atë të propozuar për ndryshim dhe karakteristikat e turbinave të propozuara.
- Shoqëria "Air –Energy" SH.P.K., në kërkesën e saj ka sqaruar se: nga kompania profesionale Focus kanë pranuar mendimin profesional dhe sugjerimet për shfrytëzimin racional të hapësirës së rrafshnaltës së Kitkës me kapacitet dhe teknologji të reja të cilat shfrytëzojnë hapësirën e njëjtë dhe japin rendiment më të larta.
- Gjithashtu ka sqaruar se bazuar në sugjerimet e kompanive profesionale pas studimit dhe analizimit të erës si dhe avancimit të teknologjisë nga prodhuesit e erës në këtë rast General Electric, ju njoftojmë se trendët bashkëkohore të turbinave të erës janë në drejtim të rritjes së kapaciteteve për njësi në mënyrë që të shfrytëzohet më pak ambient hapësinor.
- Andaj, bazuar në këtë që tha më lartë dhe dokumentet e bashkangjitura në mbështetje të kërkesës, kanë kërkuar nga Bordi i ZRRE-ës, që të aprovon modifikimin e autorizimit final pasi që kapaciteti instalues nuk ndryshon përveç ndryshimit të numrit të turbinave në parkun Energjetik KITKA me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW, komuna e Kamenicës.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës për Modifikim të Autorizimit dhe dëshmime të bashkangjitura, ka vlerësuar ato, dhe ka konstatuar se kërkesa për modifikim është e bazuar, dhe dëshmitë e bashkangjitura janë bazë e mjaftueshme për të lejuar modifikimin e autorizimit Final V_824_2016 të datës 23 qershor 2016, dhe ndryshimin e numrit të turbinave nga 10 (chjet) turbina sa ishin të autorizuar në 9 (nëntë) turbina, dhe kapacitetit i instaluar mbetet i pa ndryshuar prej 32.4 MW, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Kamenicës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së